



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:105611

Datë: 19.06.2024

Numri i dokumentit: 05837162

P.nr.1558/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Bujar Ahmeti, në çështjen penale kundër të pandehurës R.N., Komuna e Artanës (Novobërdës), për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtjes së rreme, nga neni 403 par. 2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Nr.04/L-082); të pandehurit M.A., Komuna e Artanës (Novobërdës), për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtjes së rreme, nga neni 403 par. 2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Nr.04/L-082) dhe S.P., Komuna e Artanës (Novobërdës), për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtjes së rreme, nga neni 403 par. 2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Nr.04/L-082), të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.5952/2018a të datës 28.08.2020, jashtë seancës, më datë 19.06.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

- I. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.5952/2018a të datës 28.08.2020.
- II. PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurve:
 1. **R.N.**, nga babai J, dhe nëna V., mbiemri i vajzërisë se nënës V., i lindur me datë ..., në .. Komuna e Artanës (Novobërd), Komuna e Novobërdes, baba i dy fëmijëve, e martuar, e papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, serbe, shtetas i Republikës se Kosovës, i identifikuar me numër personal ...;
 2. **M.A.**, nga babai S. dhe nëna D., mbiemri i vajzërisë se nënës N., i lindur me datë ..., në Gj., Komuna e Artanës (Novobërd), i martuar, nënë e tre fëmijëve, e pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, serb, shtetas i Republikës se Kosovës, i identifikuar me numër personal ...; dhe
 3. **S.P.**, nga babai Zh. dhe nëna S., mbiemri i vajzërisë se nënës I., i lindur me datë ..., Komuna e Gjilanit, me vendbanim në ..., Komuna e Artanës (Novobërd), e martuar, nënë e tre fëmijëve, e pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, serbe, shtetas i Republikës se Kosovës, i identifikuar me numër personal ...

Të akuzuar secili veç e veç për vepra penale legalizimi i përmbajtjes së rreme, nga neni 403 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, pasi që ka arritur **parashkrimi absolut i ndjekjes penale**.

- III.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, pranë kësaj gjykate me datë 28.08.2020, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.5952/2018a të datës 28.08.2020, kundër të pandehurve R.N., M.A. dhe S.P., për shkak të veprës penale secili veç e veç legalizimi i përmbytjes së rreme, nga neni 403 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, e duke vepruar sipas detyrës zyrtare, konstatoi se në këtë çështje penale ka arritur afati kohor i parashkrimit absolut të ndjekjes penale për të pandehurit R.N., M.A. dhe S.P. Nga shkresat e lëndës rezulton se të pandehurit akuzohen secili veç e veç për veprat penale legalizimi i përmbytjes së rreme, nga neni 403 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së (i cili ishte në fuqi gjatë kohës së kryerjes së veprës penale të pretenduar), për të cilën parashihet dënimi me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet. Sipas dispozitës së nenit 106 par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, për vepër penale të dënueshme me më shumë se tri (3) vite burgim, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 5 (vite) vite, nga koha e kryerjes së veprës penale apo nga veprimi i fundit procedural, (parashkrimi relativ), kurse sipas dispozitës së nenit 107 par. 8 të KPRK-së ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Bazuar në dënimin që parashihet për këto vepra penale, rezulton se në rastin konkret ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, pasi që nga shkresat e lëndës, si dhe nga përshkrimi si në aktakuzë, del se veprat penale të pretenduara janë kryer me datë 13.05.2014, në anën tjetër në kuptim të nenit 107 par. 1 të KPRK-së afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale. Në rastin konkret duke pasur parasysh se nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, prej kohës së kryerjes së veprave penale të pretenduara me datë 13.05.2014 (gjyqtari i çështjes është ngarkuar më lëndën me datë 13.10.2023) e deri në ditën e përpilimit të këtij aktvendimi kanë kaluar më shumë se dhjetë (10) vite, respektivisht në këtë çështje penale afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale ka arritur me datë 13.05.2024, prandaj edhe u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimin për shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori konform nenit 453 par.1 të KPP-së.

Duke e marrë parasysh faktin se ekzistojnë rrethana të cilat pengojnë ndjekjen penale, konform nenit 106 par.1 nën par. 1.6 dhe nenit 107 par.8 të KPRK-së dhe nenit 357 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.1558/20 datë 19.06.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Bujar Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej tri (3) ditëve prej ditës së pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.